



№ 3 prot
Dt. 28/02/2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



VENDIM

Nr. 2, datë 23.02.2023

PËR

MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES ME NR.90/4 PROT, DATË 23.02.2017, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.4, DATË 13.02.2017 “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR QËLLIME INDUSTRIALE DHE TEKNOLOGJIKE”, TË SUBJEKTIT “VLLAZNIMI DEDA IMPORT EXPORT” SH.P.K, ME VENDNDODHJE: NJËSIA ADMINISTRATIVE SURROJ, BASHKIA KUKËS, QARKU KUKËS.

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rinovimit të lejes me Nr.90/4 prot., datë 23.02.2017, miratuar me vendimin Nr.4, datë 13.02.2017 “Për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për qëllime industriale dhe teknologjike”, të subjektit “Vllaznimi Deda Import Export” sh.p.k, me vendndodhje: Njësia Administrative Surroj, Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së burimit ujq (Përroi i Leshnicës).

- X = 4446080; Y = 4656287; Z = 445 m.m.n.d (Gauss Kruger)

- X = 528749; Y = 4656007; Z = 445 m.m.n.d (KRGJSH)

Lloji i aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: Linjë për pasurimin e kromit.

Prurja mesatare vjetore: Q= 1.44 m³/sek

Sasia e ujit që jepet për përdorim: Q= 0.004 m³/sek

Vëllimi i rrjedhës së kthyer: Q= 0.002 m³/sek

Vendi ku shkarkohet rrjedha e kthyer: Në shtratin e Përroit të Dashit

Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorura: Gropë septike

3. Leja për përdorim burimi ujq jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë dhe nevojat e bujqësisë në zonë.

4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

